101 Parime në Shërbim



Osman Nuri TOPBASH

Shkodër / 2014

Titulli origjinal: *Mânevî zirvelerin ulvî basamağı*
HIZMET

Drejtor: Albert Halili
Përktheu: Ilir Hoxha
Redaktor: Zija Vukaj
Korrektor: Dr. Irida Hoti
Kryeredaktor: Alban Kali
Design: Bledar Xama

PROGRESI sh.p.k

Adresa: Sheshi "2 Prilli" / Rr: Studenti / Shkodër / Shqipëri
Mob: +355 67 60 78484
http: www.progresibotime.com e-mail: botime@progresibotime.com

Adresa Kosovë: Rr:Ardian Zurnaxhiu / pn. Ralin / Prizren
Tel: +381 29 222 795
Fax: +381 29 222 797 e-mail: kosova@progresibotime.com

Adresa Maqedoni: Rr: Stiv Naumov / nr. 9 / lokal 25 / Shkup
Tel: +398 71 956 271 e-mail: maqedoni@progresibotime.com

101 Parime në Shërbim

Osman Nuri TOPBASH

1

Thelbi i moralit islam është kthimi me sinqeritet dhe dashuri tek Allahu. Dhe treguesi më i rëndësishëm i këtij kthimi, padyshim që është shërbimi në rrugën e Tij.





Fryti më i çmuar i besimit është mëshira, kurse pasoja e mëshirës është shërbimi. Mëshira është një dhuratë e madhe e Allahut për njeriun. Vetëm kur te njeriu ka prani mëshire, mund të flitet për ndërgjegje, përzemërsi dhe edukatë.

3



Shërbimi në rrugën e Allahut është kërkimi i kënaqësisë së Tij duke shpëtuar prej egoizmit personal dhe duke iu drejtuar çdo krijese me një shpirt altruist.



Rruga që përshkon shpirti i njeriut për të arritur kulmet e pjekurisë, kalon nëpër shkallët e mëshirës dhe shërbimit për hir të Allahut, kurse mëshira dhe shërbimi janë përpjekje për të plotësuar nevojat e nevojtarit.



Besimtari i dhembshur është bujar, modest, shërbyes dhe në të njëjtën kohë, person që gjallëron zemrat dhe freskon shpirtrat.




Shërbyesit në rrugën e Allahut, duke medituar dhe reflektuar mbi emrat e bukur të Allahut, si "Rrahman" dhe "Rrahim", dhembshurinë dhe mëshirën ndaj çdo krijese duhet t'i marrin si parimet themelore. Kjo, sepse shërbimi për hir të Allahut është një punë që kërkon ndjenja të larta mëshire.



Shërbimi në rrugën e Allahut
është një përgjegjësi shoqërore, që Zoti i Madhëruar
na e ka ngarkuar si detyrë neve, robërve të tij, sepse besimtari duhet
ta konsiderojë veten përgjegjës për ballë shoqërisë.

Shumë njerëz mendojnë se duke kryer namazin dhe agjërimin e kanë kryer detyrën e tyre fetare. Por kjo është e pamjaftueshme. Përveç respektimit të urdhëresave dhe ndalesave hyjnore, besimtari duhet të tregojë mëshirë dhe dhembshuri ndaj të gjitha krijesave, gjë e cila arrihet përmes sakrificës dhe një shërbimi të sinqertë. Besimtar i mençur është ai që mendon për të mirën e gjithë shoqërisë.





Shërbimi ndaj Allahut arrihet përmes zbatimit me dëshirë të urdhrave dhe ndalimeve të Tij dhe përpjekjeve për përhapjen e Fjalës së Allahut.

Shërbimi ndaj Profetit (a.s.), arrihet duke u djegur nga dashuria për Të, duke jetuar sipas traditës profetike dhe duke bërë përpjekje për ta mbajtur gjallë traditën profetike.





Shërbimi ndaj njerëzve të mëdhenj
të Islamit realizohet përmes shërbimit,
dashurisë dhe respektit ndaj tyre.

Shërbimi ndaj prindërve realizohet përmes fitimit të pëlqimit të tyre pa u ankuar, pa thënë as "of!"

Shërbimi ndaj bijve
realizohet përmes rritjes
së tyre si besimtarë të mirë.

Shërbimi ndaj farefisit
realizohet përmes
respektimit të afërsisë
së gjakut dhe të bërit
vetëm mirë atyre.

*Shërbimi ndaj besimtarëve
realizohet përmes ndarjes
me ta të dhimbjeve
dhe gëzimeve.*

Shërbimi ndaj të gjithë njerëzve realizohet përmes përpjekjes për t'u bërë i dobishëm për ta.

Shërbimi ndaj krijesave realizohet përmes kujdesit ndaj tyre me dhembshuri.

*Besimtarët e pajisur me vetëdijen e shërbimit,
janë si një lumë i begatë, që teksa rrjedh
në rrugën e tij të gjatë, u jep jetë e gjallëri
një mijë e një gjallesave, si njeriut, tokës,
pemës, trëndafilit, zymbylit, bilbilit etj.
Caku përfundimtar i këtij lumi është deti
i takimit të përjetshëm me Allahun.*

Njerëzit e devotshëm për të arritur shpëtimin e amëshuar përmes shërbimit dhe mëshirës kërkojnë vazhdimisht njerëz për të shpëtuar dhe shërbyer.

Një shërbyes i përsosur, në çdo shoqëri që të jetojë, me çdo kusht e ruan besimin, entuziazmin dhe identitetin e tij. Ai është një njeri, i cili e mban zemrën e tij larg dëshirës për pasuri dhe pozitë. Po ashtu, ai është gjithmonë pranë atyre që presin ndihmë dhe veçanërisht i përgjigjet me gjithë zemër thirrjes së heshtur të të vuajturve dhe të vetmuarve.

Zemra e thellë dhe e ndjeshme e shërbyesve për hir të Allahut, e cila është gatuar me vuajtjet e të përvuajturve, vlon si një mahsher. Ky përvëlim zemre e sjell atë deri tek pragu i derës që hapet drejt mëshirës dhe faljes së Allahut. Ashtu si natyra e diellit është ngrohja edhe natyra e njerëzve të arrirë është mëshira dhe dhembshuria ndaj njerëzve.

***Rumiu** thotë:*

*“**Shemsedini** më mësoi:*
Nëse në dynja ekziston qoftë një besimtar i vetëm që ka të ftohtë, atëherë as ti nuk ke të drejtë të ngrohesh.”

Shërbyesit
janë të gatshëm për të bërë detyrën
e tyre në çdo vend që arrin zemra.

Besimtari me frymë
shërbimi në çdo rast
dhe gjendje gjen
mundësinë
për të shërbyer.

Çdo punë e sinqertë në rrugën e Allahut, e cila bëhet vetëm për të fituar kënaqësinë e Allahut, duke qenë larg mendimit për përfitim nga kjo botë, është një përshkrim i kërkimit të takimit me Zotin dhe një pasqyrim i kësaj dëshire në sjellje dhe vepra.

Një shërbyes i vërtetë
nuk ka ambicie për gjëra
të kësaj bote dhe nuk pret
shpërblime materiale,
por qëllimi i tij i vetëm
është kënaqësia hyjnore.
Vetëm në këtë mënyrë
ai do ta fitojë edhe dashurinë
e Allahut, edhe dashurin
e njerëzve të cilëve
u shërben për hir të Allahut.

Që shërbimi
të jetë i vlefshëm tek Allahu,
duhet të bëhet për hir të Tij
dhe të tregohet kujdes,
edukatë dhe mirësjellje
ndaj personave të cilëve
u shërbehet.

Prej shërbimeve
që nuk kanë të bëjnë fare me moralin e bukur,
që bëhen me arrogancë dhe në mënyrë fyese,
nuk mund të shpresosh asgjë të mirë.
Një shërbim pa mëshirë dhe edukatë
bëhet shkak për të thyer zemra njerëzish.

Shërbyesi në rrugë të Allahut
duhet të vrapojë në ndihmë të çdo krijese,
madje edhe mëkatarit duhet t'i afrohet me mëshirë.
Ai duhet t'i pushtojë zemrat me gjuhë të ëmbël,
finesë dhe mirësjellje.

Ata që punojnë
në rrugën e Allahut,
janë të detyruar të tregojnë
kujdes dhe delikatesë
në sjelljet e tyre,
njësoj sikur të ishin duke ecur
mbi një tokë të minuar.

Që shërbimet e bëra të pranohen
tek Allahu, ato duhet të kryhen
me edukatë serioze dhe ndjenja të larta.
Ata që gjenden në shërbim,
nuk duhet ta harrojnë në asnjë mënyrë
këshillën e Abdullah ibn Munazilit:
"Edukata gjatë shërbimit është më e
rëndësishme se vetë shërbimi".

Kryerja e shërbimit
në mënyrë vulgare dhe fyese,
jo vetëm që nuk i sjell shpërblim atij që e bën,
por përkundrazi, mund të bëhet
edhe shkak që ai të hyjë në gjynah. Kjo,
sepse ndreqja e një zemre të thyer
nuk i përngjan ndreqjes së diçkaje materiale.

***Junus Emre** thotë:*

"Një hoxhe që thyen zemra,
për çfarë i vlen gjithë ajo përpjekje
për të shkuar në Haxh!?"

Mbështetja e shërbyesit është Zoti,
kurse ushqimi i tij, durimi.
Çelësi kryesor i suksesit në shërbim,
është durimi dhe këmbëngulja.

Shërbimi nuk është diçka kalimtare,
por një detyrë e shenjtë
që zgjat deri në frymën e fundit
të jetës.

Tek disa persona, të cilët shërbejnë për një kohë të gjatë në rrugën e Allahut, me kalimin e kohës formohet një ndjenjë ngopjeje kundrejt shërbimit në rrugën e Allahut, çka shënon fillimin e rrezikut për ta. Ndjenja "mjaft më!", është një pëshpëritje egoiste, që e tërheq personin drejt kësaj bote.

Shërbimi në rrugën e Allahut, si një stil jetese e pejgamberëve dhe e robërve të dashur të Allahut, është një virtyt kaq i lartë, saqë këta personalitete nuk hoqën dorë prej tij edhe kur ishin të sëmurë, madje edhe kur gjendeshin në shtratin e vdekjes.

*Ata që shërbejnë në rrugën e Allahut,
nuk duhet ta heqin nga goja dhe zemra
këtë lutje të Pejgamberit: "O Zoti im! Kërkoj
mbrojtjen Tënde nga dobësia, përtacia,
frika dhe pafuqia..." (Buhari, Deauat, 38)*

Ashtu siç nuk është e drejtë që një person të lërë mënjanë dhe të neglizhojë familjen, prindërit dhe punën me të cilën fiton riskun, po ashtu është e papranueshme që duke u justifikuar me ta, të qëndrojë larg shërbimit për hir të Allahut.

Shërbimi ndaj njeriut, një krijesë e cila është krijuar vetëm për të adhuruar Allahun, është një lloj grade, e cila dëshmon për devotshmërinë ndaj Allahut. Allahu merr përsipër zgjidhjen e vështirësive personale të atyre që shërbejnë për fenë e Tij dhe që merren me zgjidhjen e problemeve të robërve të tjerë. Kurse ata që merren vetëm me interesat dhe problemet personale, Ai i lë vetëm për vetëm me problemet e tyre.

Sadik Xhaferi thotë:

"Allahu i tha dynjasë:
Shërbeji atij që më shërben Mua
dhe braktis atë që të shërben ty."

Është fatkeqësi e madhe për ne,
nëse nuk e ngremë entuziazmin
për mëshirë dhe shërbim mbi të gjitha
dashuritë e përkohshme të kësaj bote.

Nga ana tjetër, na është përcaktuar edhe masa e detyrueshme që duhet të dhurojmë prej pasurisë. Në këtë mënyrë, ai që jep zekatin e pasurisë, ka përmbushur edhe minimumin e asaj që duhet të shpenzojë në rrugën e Allahut. Mirëpo, për shkak se është e pamundur të përcaktohet sasia e mirësive dhe mundësive që Allahu, ia ka dhuruar njeriut, ne jemi të detyruar të shërbejmë në rrugën e Allahut deri në frymën tonë të fundit. Sepse Allahu në Kuran thotë:

***"Pastaj, atë Ditë, do të pyeteni për kënaqësitë** (e kësaj bote)**!"** (Tekathur, 8)*

Ata që kanë të gjitha mundësitë, por duke parë vetëm interesat e tyre vetjake dhe duke nxjerrë një sërë pretekstesh, u largohen shërbimeve ndaj të tjerëve, u ngjasojnë pemëve që nuk japin fruta. Poeti i shquar, Nexhip Fazlli shprehet: "Pema që nuk jep frute është thjeshtë dru."

Vlera e një shërbimi varet nga sakrifica që tregohet dhe nga kryerja e tij me entuziazmin e një adhurimi.

Ai nuk duhet të harrojë kurrë se eliksiri i lumturisë, uji i jetës, në të shumtën e rasteve fshihet në kohët e vështira dhe në vendet e vuajtjeve.

Shërbimi në zemrën e besimtarit nuk sjell lodhje, përkundrazi, ai shërben si kënaqësi, çlodhje dhe qetësi.

Zemra e njeriut që shërben në rrugën e Allahut, duhet të jetë si një tokë e begatë. Gjallesat që lëvizin mbi tokë ushqehen nga ajo dhe nxjerrin jashtë tepricën. Por toka e pastron të gjithë këtë papastërti dhe duke mbirë bimë të shumëllojshme, njëra më e bukur se tjetra, i ushqen të gjitha krijesat që lëvizin mbi të.

Shërbimi, nga një anë, u sjell dobi të tjerëve, ndërsa nga ana tjetër, në varësi të përpjekjeve dhe sinqeritetit, ai bëhet shkak për lartësimin e atyre që shërbejnë. Madje, dobia që përfitojnë shërbyesit në rrugën e Allahut është më e madhe se ajo që përfitojnë ata të cilëve u shërbehet.

Shërbyesit në rrugën e Allahut i ngjajnë hënës dhe diellit në qiell, që u japin jetë edhe qosheve më të largëta. Ndërkohë që ndriçojnë përreth vetes, shkëlqimi i tyre shtohet edhe më tepër.

***Ali Ramiteni** thotë:*

"Ka shumë që shërbejnë duke i detyruar nevojtarët t'ua dinë për nder (duke ua kujtuar mirësinë e bërë) dhe janë të paktë ata që shërbejnë për hir të Allahut, duke e konsideruar këtë punë si një mirësi për ta. Nëse do ta konsideronit si mirësi mundësinë që ju është dhënë për të shërbyer për hir të Allahut dhe do t'ua dini për nder nevojtarëve të cilëve u shërbeni, të gjithë do të jenë të kënaqur dhe do të pakësohen ankesat ndaj jush..."

***Sadiu** thotë:*

"Falënderoje Allahun, që të dha mundësi të bësh mirë, sepse Ai nuk të privoi nga mirësia e Tij. Ai që i shërben padishahut, nuk mund të pretendojë mirënjohje prej tij. Përkundrazi, ai duhet t'i jetë mirënjohës atij që e mori në punë."

Të jesh një shërbyes i vërtetë në rrugë të Allahut, është një nder i lartë, që Allahu i Madhëruar mund t'i japë robit të Tij. Prandaj, duhet t'ia dimë mirë vlerën kësaj mirësie dhe të përpiqemi që çdo punë ta bëjmë me sinqeritet dhe duke qenë në rrugë të drejtë. Në të kundërtën, nuk duhet të harrojmë se kjo mirësi mund të na merret nga duart.

***Sadiu** thotë:*

"Virtyti në shërbim, është kur falënderon duke mbajtur peshën e të dobëtve, ndërkohë që e sheh veten të fortë e të shëndetshëm."

***Musa efendiu** thotë:*

"Ne duhet të kuptojmë se jo gjithkujt i jepet mundësia të bëjë diçka në rrugën e Allahut. Ka shumë njerëz që, megjithëse janë të aftë të bëjnë shumë punë, nuk mund të shërbejnë për hir të Allahut, vetëm se nuk kanë kohë dhe vend të përshtatshëm. Ata që punojnë në rrugën e Allahut duke e njohur këtë punë si një mirësi, e shtojnë akoma më shumë përulësinë dhe falënderojnë pa fund ata të cilëve u shërbejnë, që u bënë shkak për këto mirësi."

Kush shërben, do të begatohet!

Ubejdullah Ahrari *ia atribuon nivelin e lartë shpirtëror që kishte arritur, begatisë së shërbimit në rrugën e Allahut dhe si falënderim ndaj kësaj mirësie, thotë: "Përparimin në këtë rrugë nuk e arritëm vetëm duke lexuar libra mistikë, por duke i zbatuar sipas mundësisë ato që lexonim dhe duke i shërbyer popullit për hir të Allahut. Kjo i dërgoi të gjithë në një rrugë, kurse ne na dërgoi në rrugën e shërbimit për hir të Allahut."*

***Abdullah Dehlevi** thotë: "Të parët tanë u jepnin së pari si detyrë nxënësve shërbime të ndryshme, sepse shërbimi është shkak për lartësimin shpirtëror dhe fitimin e Xhenetit."*

Mevlana i nderuar, *në lidhje me pjekurinë shpirtërore që përfiton njeriu nga shërbimi për hir të Allahut, shprehet:*

"Nëse shikoni me syrin e zemrës,
të cilin e përfitoni nga adhurimet, dhurimet, mirësitë dhe shërbimet që bëni, do të shihni edhe ngjyra të tjera përveç atyre që shihni zakonisht. Në vend të gurëve të rëndomtë, do të shihni perla e xhevahire. E çfarë është perla në fund të fundit? Ti vetë bëhesh det, bëhesh diell, që lundron e shëtit në qiell."

Shërbimet e sinqerta dhe të vërteta
janë një kryevepër e pjekurisë së zemrës.
*Dhe zemra të tilla janë **vendi i shikimit hyjnor.***





Shërbimet dhe veprimtaritë shërbyese
japin fryte sipas gjendjes dhe pjekurisë së zemrës,
prandaj shërbyesi duhet t'i japë rëndësi
të madhe ushqimit shpirtëror.



***Musa efendiu** thotë:*

"Shërbyesi në rrugë të Allahut, në të njëjtën kohë
duhet të bëjë përpjekje maksimale për t'u lartësuar shpirtërisht.
Shërbyesi duhet t'ia dorëzojë zemrën Allahut
dhe të bëjë detyrat e ibadetit me përpikëri, sinqeritet dhe modesti.
Përndryshe, shërbimi që nuk mbështet në botën shpirtërore dhe metodën profetike e dobëson njeriun shpirtërisht."



Shërbimi është po aq i nevojshëm për lartësimin shpirtëror, sa edhe dhikri. Por lënia pas dore e namazit të natës dhe dhikrit, duke nxjerrë si pretekst shërbimin është shumë e gabuar.



Shërbyesi në rrugën e Allahut nuk duhet të neglizhojë asnjëherë historitë e përmendura në Kuran, këshillat e pejgamberëve, të sahabëve dhe robërve të dashur të Allahut, të cilat do ta ndriçojnë në rrugën gjatë realizimit të shërbimit. Ato duhet të lexohen në mënyrë të vazhdueshme.

Shërbimi më i madh që mund t'i bëhet një njeriu, është ta ndihmosh atë të fitojë ardhmërinë e përjetshme. Dhe rruga që të çon te kjo, është ta drejtosh atë në devotshmërinë e vërtetë. Kjo është e mundur vetëm duke përvetësuar moralin e Kuranit Kerim dhe duke e ndërtuar jetën në bazë të kritereve të tij.





Nëse shërbyesi në rrugën e Allahut nuk zhvillohet shpirtërisht, egoja e tij merr përparësi dhe shërbimet që kryen nuk japin asnjë fryt. Si përfundim, nuk arrihet asgjë tjetër përveç lodhjes së kotë.



Sinqeriteti dhe rruga e drejtë duhet të jenë

dy cilësitë themelore të shërbyesit në rrugën e Allahut.

Që një shërbim të pranohet nga Allahu, duhet të ketë për

qëllim fitimin e kënaqësisë së Tij.


*Një shërbim i privuar nga frymëzimi shpirtëror,
i ngjan një kove me ujë që derdhet në shkretëtirë. Një farë që hidhet në tokë të thatë përfundon në barkun e minjve të arave. Kurse farat e punës në rrugën e Allahut, që hidhen me frymëzim shpirtëror, janë si pemët e mëdha të cilat qëndrojnë fort në rrugën e drejtë.*





Ai që hyn në shërbim për hir të Allahut, duhet të lutet e të kërkojë ndihmë nga Allahu, duke qenë i vetëdijshëm për dobësinë dhe nevojën e tij. Në një ajet fisnik, urdhërohet:

"O besimtarë! Kërkoni ndihmë për veten me durim dhe namaz! Në të vërtetë, Allahu është me të duruarit." *(Bekare, 153)*



Çështja për të cilën duhet të kenë më shumë kujdes shërbyesit në rrugën e Allahut, është vetëdija se suksesin nuk e kanë nga vetvetja, por nga Allahu. T'ia atribuosh një gjë të tillë vetes, bëhet shkak i mendjemadhësisë dhe mendjelehtësisë, gjë e cila është një fatkeqësi shpirtërore shumë e madhe.



***Musa efendiu** thotë:*

"Shërbyesit në rrugën e Allahut duhet të jenë altruistë.
Ata që përpiqen t'i bëjnë të gjithë shërbimet vetë,
lodhen shumë shpejt, fillojnë t'i shikojnë të tjerët më të vegjël
dhe bëhen robër të dëshirave për pozitë."

***Musa efendiu** thotë:*

"Përpjekja jonë është shërbimi si një ushtar pa grada."




Shprehja e Pejgamberit:

"Zotëria i një populli është ai që u shërben atyre."
(Bejhaki, Shuab, I, 334)

do të thotë se ata që ndodhen
në krye të shërbimit nuk duhet
të presin t'u shërbehet,
por duhet të zotërojnë një shpirt
të përkushtuar në shërbimin
ndaj të tjerëve.



Ai që ndodhet në krye të shërbimit,
duhet të përpiqet më shumë dhe të jetë më aktiv
se ata që ka nën urdhra, me qëllim që të jetë
shembull për ta.



Ata që gjenden në rrugën e shërbimit për hir të Allahut, nuk duhet t'i bëjnë punët vetëm duke urdhëruar të tjerët, por duhet të japin edhe kontributin e vet personal, duke u përkushtuar me gjithë zemër në shërbim. Ata që nuk kapin punë me dorë, por thjesht japin urdhra përqark nga vendi ku rrinë ulur, duke pandehur se shërbejnë për hir të Allahut, janë njerëz që nuk e kanë kuptuar thelbin e çështjes.



Shërbimi nuk realizohet
përmes urdhrave dhe komandave,
por duke qenë vetë në krye të shërbimit.





Tek shërbyesi fetar, "egoja" dhe "pretendimi",
duhet t'ia lënë vendin pasionit,
dashurisë dhe modestisë.

Shërbyesi i vërtetë dhe i pjekur
është një njeri i zemrës, që e pranon veten
në fund të karvanit të shërbimit.



79

Aliu (r.a.), thotë:

"Pozita e lartë e një personi nuk duhet të bëhet kurrë shkak që një shërbim të vogël ta konsiderojë të madh dhe pozita e vogël e një personi një shërbim të madh ta konsiderojë të vogël."




Musa efendiu thotë:

"Besimtari nuk duhet të shikojë se sa i madh apo i vogël është adhurimi, po kur t'i jepet rasti, duhet të përpiqet t'i bëjë të gjitha me sinqeritet. Sepse shumë njerëz që bëjnë punë të mëdha në shërbimin për hir të Allahut, nuk u japin rëndësi punëve që duken të vogla gjatë shërbimit. Ata nuk e dinë se në cilën prej tyre është kënaqësia e Allahut. Ne duhet të kuptojmë se jo gjithkujt i jepet mundësia të bëjë diçka në rrugën e Allahut. Ka shumë njerëz që, megjithëse janë të aftë të bëjnë shumë punë, nuk mund të shërbejnë për hir të Allahut, vetëm se nuk kanë kohë dhe vend të përshtatshëm. Ata që punojnë në rrugën e Allahut duke e njohur këtë punë si një mirësi, e shtojnë akoma më shumë përulësinë dhe falënderojnë pa fund ata të cilëve u shërbejnë, që u bënë shkak për këto mirësi.".”



Musa efendiu *thotë:*

"Nuk duhet lënë pasdorë shërbimi i
vogël me pretekstin
se po bëj një shërbim të madh,
sepse kur akumulohen punët e vogla
bëhet një punë e madhe."






Shërbyesit për hir të Allahut
nuk duhet të jenë prodhues problemesh, por zgjidhës të tyre.
Në vend që të kërkojnë mangësi e të meta duke e kthyer
punën në fjalë boshe e kritika, ata duhet t'u qasen çështjeve
me një frymë konstruktive dhe pozitive.

83 *Ata që shërbejnë në rrugën e Allahut, nuk duhet të hetojnë për të gjetur të metat e të tjerëve, por duhet t'i mbulojnë ato nëse i vënë re. Për këtë, Pejgamberi i Allahut ka thënë: "Kush e mbulon të metën e shokut, në Ditën e Kiametit edhe Allahu i mbulon të metat e tij. Kush i nxjerr në shesh të metat një vëllai mysliman, edhe Allahu ia nxjerr në shesh të metat e tij. Madje, e poshtëron atë me të metat e tij, edhe nëse ai ndodhet në shtëpinë e vet."*

(Ibn Maxhe, Hudud, 5)





Ai që shërben, nuk duhet të fajësojë të tjerët për çalimin e punëve dhe më parë duhet të kërkojë të metat tek vetja. Pra, me të tjerët duhet të jetë tolerant, kurse ndaj vetes qortues.



Shërbyesit në rrugën e Allahut duhet ta harrojnë ndjenjën e zemërimit, sepse zemërimi në përgjithësi është prirje për të përçmuar të dobëtit.



Shërbyesi në rrugën e Allahut duhet të jetë i ekuilibruar, duhet të ketë zgjuarsi dhe horizont të gjerë. Ndërsa zemra dhe mendja e tij duhet të ndriçohen me dritën e urtësisë. Gjithashtu, ai nuk duhet t'i kalojë kufijtë, por duhet të ruajë ekuilibrin mes dashurisë dhe urrejtjes, komplimentit dhe kritikës, lavdërimit dhe fyerjes. Ai duhet të zotërojë një sinqeritet që nuk arrin në familjaritet të tepruar dhe një maturi që nuk kthehet në mendjemadhësi. Edhe pse duhet të jetë modest, ai nuk duhet të lejojë të poshtërohet.




Shërbyesit në rrugën e Allahut duhet të pastrohen nga ndjenjat negative, të cilat largojnë begatinë dhe frymëzimin për shërbimin në rrugë të Allahut, si urrejtja ndaj njëri-tjetrit, zilia, ftohtësia etj. dhe duhet të përfitojnë prej esencës frymëzuese të dashurisë, e cila dëlirëson dhe maturon shpirtrat.

Në shërbimin për hir të Allahut, të veprosh duke u këshilluar me të tjerët, është një urdhër hyjnor dhe një sunet shumë i rëndësishëm.

Allahu i Madhëruar *urdhëron:*

"...dhe këshillohu me ata *(besimtarët)* ***për çështje të ndryshme..."*** *(Al 'Imran, 159)*





Njeriu që shërben për hir të Allahut, duhet të dijë t'i përdorë në mënyrën e duhur amanetet që ka marrë përsipër. Ashtu si e ruan mallin dhe pasurinë e tij nga shpërdorimi, ashtu duhet ta ruajë edhe mallin, pasurinë dhe shërbimin në fushën e edukimit, të cilat i janë besuar.

Pikësëpari, shërbyesit në rrugën e Allahut duhet të shfaqin një karakter të fortë, sepse njerëzit mahniten pas një njeriu me karakter të fortë, të matur dhe me personalitet shembullor. Për këtë arsye, ata i ndjekin kudo duke marrë shembull prej tyre.

Shërbyesit në rrugën e Allahut, duhet të zotërojnë njohuritë, aftësitë dhe përvojën e duhur për të shërbyer. Nëse ky kualifikim nuk fitohet, jo vetëm që nuk mund të arrihet synimi i shërbimit, por ky shërbim mund të krijojë edhe pasoja të dëmshme. Shërbimet që bëhen në mënyrën më të bukur dhe cilësore, nuk humbasin kurrë. Në lidhje me këtë, Allahu i Lartësuar urdhëron:

"...Padyshim se Ne nuk do t'ua humbim shpërblimin punëmirëve..." *(Kehf, 30)*

Një shërbyes pa dituri dhe përvojë të mjaftueshme, që nuk i jep rëndësi përmirësimit moral e shpirtëror të vetes dhe nuk është i kualifikuar në punën e tij, nuk mund të japë fryte serioze në shërbimin që kryen.

Shërbimi i një njeriu të kultivuar është shpesh i njëjtë me shërbimin e një mijë vetave. Sepse njeriu i aftë nuk i shpërdoron mundësitë që i jepen.

Shërbimi më i madh në ditët tona është ngritja e institucioneve që do të edukojnë njerëz shembullorë dhe të aftë. Siç thotë një mendimtar: "Dallimi kryesor midis popujve sundues dhe të sunduar është një grup i vogël i njerëzve të mirëedukuar dhe mirëarsimuar."

Njeriu shërbyes duhet të ketë zgjuarsi dhe horizont të gjerë. Ndërsa zemra dhe mendja e tij duhet të ndriçohen me dritën e urtësisë.

Ta njohësh mirë personin të cilit po i shërben, është po aq e rëndësishme sa vetë shërbimi që bën. Kjo, sepse vetëm në këtë mënyrë mund të arrihet suksesi dhe saktësia në shërbim. Për shembull, mënyra e ndihmesës ndaj një personi që dikur ka qenë i pasur, por më pas është varfëruar dhe ka turp të tregojë gjendjen e tij, nuk është e njëjtë me mënyrën e ndihmesës ndaj një personi tjetër, që është mësuar dhe nuk i vjen zor të shfaqë nevojat e veta. Në një ajet urdhërohet: "(Lëmosha) ***u takon të varfërve, të cilët kanë hyrë në rrugën e Zotit e nuk janë në gjendje të udhëtojnë*** *(për të fituar).* ***Kush nuk i njeh ata, kujton se janë të kamur, për shkak se ata nuk lypin. Do t'i njohësh nga pamja e tyre. Ata nuk i mërzisin njerëzit duke lypur. E çdo gjë që shpenzoni prej të mirave, Allahu i di ato."*** *(Bekare, 273)*

Emir Kylali *thotë:*

"Përpiqu të fitosh zemra; shërbeju të pafuqishmëve! Mbroji të dobëtit, zemërthyerit! Ata janë persona të tillë, që nuk kanë asnjë të ardhur nga populli. E megjithatë, ata jetojnë me një zemër plotësisht të qetë dhe me modesti. Kërkoji dhe gjeji ata!"

***Shejh Sadi** këshillon me këto fjalë:*

"Nëse je i thatë e pa dashuri, kur të vdesësh, ashtu si me trup do të vdesësh edhe me emër.
Nëse je zemërgjerë dhe shërbyes në rrugën e Allahut, jeta jote vazhdon edhe pas trupit tënd të përkohshëm, aq sa ke sakrifikuar dhe ke hyrë në zemrat e të tjerëve."

*Nuk duhet të harrojmë
që një vdekje e mirë
është shpërblim i një jete
të kaluar sipas Kuranit
dhe gjurmëve të traditës
profetike.*

Ahmet Kasani *thotë:*

"Bota është vend shërbimi, kurse ahireti është vend afrimi tek Allahu. Afrimi i njeriut tek Allahu është në raport të drejtë me shërbimin e kryer në këtë botë."

Allahu në Kuran thotë: ***"Në të vërtetë, Allahu ka blerë nga besimtarët jetën dhe pasurinë e tyre, në këmbim të Xhenetit."*** *(Teube, 111)*

Zoti na e mundësoftë të gjithëve të përfitojmë ashtu siç duhet nga këto virtyte të larta! Gjithashtu, na e mundësoftë të ndjejmë mbi supet tona përgjegjësinë për çdo vend që ka nevojë për shërbim, por që e kemi të pamundur të shkojmë deri atje. Allahu na faltë të gjithëve një jetë shërbyese plot urtësi, zell dhe përpjekje! Po ashtu, u faltë zemrave tona entuziazëm për të shërbyer dhe bëftë që përpjekjet tona të jenë në përputhje të plotë me kënaqësinë e Tij. Amin!..